


Libra të rinj

Teuta Shala-Peli “DAYS OF THE PROUD PAIN”

Botoi: Instituti i Historisë-Prishtinë, 2018, 179 f.



Ditë më parë, doli nga shtypi në gjuhën angleze libri: “Days of the proud pain”, i autorës Prof.ass.dr.Teuta Shala-Peli. Libri “Days of the proud pain”, është rezultat i punës disavjeçare, ku si thelb i trajtimit të problemeve në këtë libër është periudha, e cila kap harkun kohor 1998-1999, duke u fokusuar në mënyrë të veçantë ngjarjet e muajvëmaj-qershor të vitit 1999, në disa fshatra të komunës së Pejës (Qyshk, Pavlan dhe Zahaq), synuar që të sjellë sa më shumë dëshmi për tërë ato që ndodhën në periudhën maj-qershor 1999. Libri krahas Parathënies dhe Hyrjes, është i ndarë në pesë kapituj. Kapitulli i parë “Krimet serbe në disa fshatra të komunës së Pejës në maj të vitit 1999”, është i ndarë në katër nënkaptuj, në kuadër të të cilëve trajtohet masakra e 14 majit 1999 në fshatrat Qyshk, Pavlan dhe Zahaq.

Kapitulli i dytë “Masakra e 14 majit në kujtesën e të mbijetuarve”, është e ndarë në pesë nëntituj, në kuadër të të cilit kapitull, janë përfshirë dëshmitë e atyre që i mbijetuan këtij krimi, pa dëshmitë e të cilëve nuk do të mund të ishte dëshmuar dhe argumentuar me fakte tërë ai krim, që ndodhi ditën e 14 majit 1999.

Kapitulli i tretë “Njësitët dhe pjesëtarët e njësiteve serbe që kanë marrë pjesë në masakrën e 14 majit 1999 në Qyshk, Pavlan dhe Zahaq”, është i ndarë në dy nëntituj. Në fokus të këtij kapitulli, janë njësitët serbe dhe pjesëtarët e atyre njësiteve që morën pjesë në masakrën e 14 majit 1999 në fshatrat Qyshk, Pavlan dhe Zahaq, gjithnjë duke u mbështetur në dëshmitë e dëshmitarëve, të cilët arritën t’i identifikojnë disa nga ata që morën pjesë në këtë masakër, si dhe në aktakuzat e ngritura ndaj tyre nga tribunale dhe gjykata që merren me krimet e luftës.

Kapitulli i katërt “Të dhëna biografike për të vrarët në maj qershor 1999”, është i ndarë në dy nënkaptuj, ku prezantohen biografitë e të vrarëve dhe të masakruarve, si dhe lista e personave të vrarë, plagosur, zhdukur dhe të mbijetuar në fshatrat Qyshk, Pavlan dhe Zahaq, 1998-1999.

Kapitulli i pestë “Faksimile, fotografi dhe dëshmi të tjera për mënyrën e vrasjes dhe masakrimin të popullsisë civile më 14 maj 1999”, është i ndarë në tre nëntituj, në kuadër të të cilëve, janë paraqitur faksimile, fotografi dhe dëshmi të tjera, të cilat argumentojnë dhe vënë në pah krimet e kryera nga forcat serbe gjatë muajit maj-qershor në fshatrat Qyshk, Pavlan dhe Zahaq. Libri “Days of the proud pain”, është i pasuruar edhe me aparaturë shkencore, ngase përmban përfundimin, rezymenë edhe në gjuhën angleze, pastaj, treguesin e emrave, një literaturë të përzgjedhur, si dhe intervistat dhe dëshmitë e dëshmitarëve, mbi bazën e të cilave është ndërtuar pjesa më e madhe e këtij libri.

Libri: “Days of the proud pain”, prezanton një pjesë të historisë më të re të Kosovës, e cila fatkeqësisht karakterizohet me dhunë, vrasje, masakrime, dëbime, kidnapime e forma të tjera të dhunës, nga forcat serbe në prag të shekullit XXI.